



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16, 17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/I-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi si dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 17.04.2020, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDIHMA TË FAMILJEVE NË NEVOJE DHE NEVOJAT TË TJERA TË MENAXHIMIT TE SITUATËS EMERGJENTE NGA PANDEMIA COVID - 19

Neni 1.

NDAHET, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 120,000.00€ (njeqind e njetzet mij euro) për ti mbështetur financiarisht familjet në nevojë në Komunën e Lipjanit si dhe për nevoja tjera me qëllim të menaxhimit të situatës emergjente nga pandemia COVID-19 që ka prekur edhe Komunën e Lipjanit.

Neni 2.

Mjetet e cekura në nenin 1 të këtij Vendimi, do të ndahen nga buxheti i Komunës së Lipjanit për vitin 2020, kategoritë ekonomike si vijon:

**Infrastruktura Publike, kodi i programit (18163) kategoria Investime kapitale projektet:
Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës Lipjan (kodi 47780) fondi burimor (10)...
79,500.00,**

Kulture rini dhe sport, kodi i programit (85003)

**Ndertimi i palestres se re sportive ne Lipjan (kodi 49379) fondi burimor (10)
.....28,000.00,**

Arsim Fillor kodi i programit(93060)

**Zgjerimi dhe instalimi i kamerave IEA (kodi 49380) fondi burimor
(10).....12,500.00.**

Neni 3.

Mjetet e lartcekura nga neni 2 transferohen ne kategorin e Mallrave e Sherbimeve ne kete drejtorat:

Sherbimet e Kujdesit Primar Shendetesor kodi i programit (73200) ne sherbime tjera kontraktuese (kodi 13460)

..... 120,000.00

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 5.

Ky Vendim për shkak të situatës emergjente të shëndetit publik dhe nevojës urgjente për të vepruar hyn në fuqi menjëherë ditën e miratimit

15Nr. 400-16849

Lipjan, më 17.04.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

